

# FUÇIA E MEDIAS



## NE ZGJEDHIM SI TË JETOJMË

ARDI (12), DION (11), SUMEJA AR. (11), PREMTIN (12), SUELA (11), SUMEJA AB. (11)



**Si nxënës që jemi, është shumë e rëndësishme të dijmë vlerën që ka vota e qytetarëve në demokraci, si dhe ndikimin e ligjeve në jetën tonë. Prandaj, edhe në këtë artikull kemi shkruar për zgjedhjet dhe ligjet në demokraci**

Ishte mëngjesi i së dielës, mot me diell. Vesa, një qytetare mjaft e përgjegjshme, u zgjua nga gjumi, u përgatit, hëngri mëngjesin dhe u nis për të shkuar në vendvotimin e caktuar. Ajo shkoi atje për të votuar për përfaqësuesit e komunës, siç janë Kryetari i Komunës dhe asamblistët.

Vesa ishte e punësuar në një fabrikë, por gjendja e fabrikës ishte jo edhe aq e mirë. Kandidati për Kryetar të Komunës kishte premtuar se do t'i përmirësonte kushtet në fabrikën ku ajo punonte. Pas disa ditësh, dolën rezultatet dhe në këto zgjedhje komunale, fitoi pikërisht ai përfaqësues, i cili u votua nga Vesa.

Kryetari i Komunës e mbajti premtimin dhe investoi në

fabrikë. Pas ca vitesh, ajo u bë një ndër fabrikat më të mira në rajon. Vesa kishte menduar mirë para se të votonte, dhe pa dyshim se kishte bërë zgjedhjen e duhur. Me këtë shembull, ne e kuptojmë sesa të rëndësishme janë zgjedhjet dhe votat e qytetarëve.

Edhe unë, si fëmijë gjithmonë zbatoja ligjin. U rrita dhe vazhdoj të zbatoj atë, por dita-ditës pashë se ka të tjerë të cilët nuk e respektojnë ligjin.

Sytë më shkonin sa tek një mbeturinë sa tek tjera, pastaj te veturat të cilat shkonin më shpejtë se sa e caktuarin shenjat e komunikacionit. Mendova dhe mendova, derisa mu kujtua që mund të vetëdijësoj të tjerët duke iu treguar rëndësinë që kanë ligjet në jetën tonë. Kështu fillova duke ua shpjeguar shumë të rinjëve, se çfarë ndikimi kemi ne si qytetarë në vendin ku jetojmë. Pas çdo shpjegimi ua thoja një mesazh: „Të respektojmë dhe të zbatojmë ligjet, sepse e ardhmja është në duart tona.“



E drejta e punës, e drejtë e secilit



„Grupi i Çudirave“

## POPULLI AKTIV QEVERIS VENDIN


TEUTA (13), PAJTESA (11), HADI (11), ARIANIT (11), SUELA (11), BARDHI (12)

**I dashur popull dhe të dashur qytetarë të Kosovës. Ne e dimë se ju e keni fuqinë në duart tuaja për të ndryshuar vendin. Por, si e bëni ju këtë? Pikërisht për këtë temë ne kemi shkruar në artikullin tonë**

Sot në „Demos-ti“ mësuam se çfarë është demokracia. Ajo rrjedh nga dy fjalë greke. „Demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. Demokracia me formën e parë të saj u shfaq në Athinë në vitin 507 p.e.r. Kjo quhej demokracia direkte. Në atë kohë, nuk pranoheshin të merrnin pjesë në takime vendimmarrëse: gratë, të varfërit, jo vendasit, të mosshuarit apo fëmijët. Ne mendojmë se kjo nuk është e drejtë, pasi që është më njerëzore dhe më demokratike që t'i përfshijmë të gjithë qytetarët. Në demokracinë e mirëfilltë, nuk lejohen dallimet apo diskriminimet

ndaj askujt. Sot ne në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese. Kjo do të thotë se ne qytetarët e Kosovës gëzojmë shumë të drejta.

Një e drejtë shumë e rëndësishme është e drejta e votës. A e gëzojnë këtë të drejtë edhe fëmijët? Jo, fëmijët nuk e gëzojnë këtë të drejtë pa i mbushur 18 vjet. Personat të cilët kanë këtë moshë mund edhe të marrin pjesë në protesta paqësore, marshe, apo edhe të nënshkruajnë peticione. Kjo vetëm falë sistemit të demokracisë. Edhe ne si fëmijë mund të bëjmë gjëra të mira për vendin tonë. Tani do t'iu tregojmë për këtë.



Një e drejtë që të gjithë duhet ta shprehin në demokraci



Pa ne, demokracia nuk do të ekzistonte

Ne si fëmijë kemi një ide. Ne do të mbledhim të holla për të blerë sa më shumë libra për nxënësit, të cilët nuk kanë mundësi t'i blejnë ato. Gjithashtu do të vizitojmë disa afishe vetëdijësuese për t'i ftuar qytetarët

që të kujdesen për ambientin ku jetojnë. Kjo për neve është shumë me rëndësi, sepse pa ambient të pastërt, ne nuk mund të jemi të shëndetshëm. Edhe gjeneratat e ardhshme e meritojnë të jetojnë shëndetshëm.



Ne, qytetarët Kosovar mund të flasim në emrin tonë



Të gjithë ne mund t'i bëjmë realitet ëndrrat tona

## MEDIA, ZGJERIM I NJOHURIVE TONA

LEDION (11), OSMAN (11), ANALEONA (11), RINA (11), SHKUMBIN (12), LUAN (11)

Më në fund! Po e shikoj edicionin e lajmeve. Të shoh se çfarë po ndodh në vendin tonë!



### Media na ndihmon që të jemi në hap me kohën, për sa i përket ngjarjeve që ndodhin si brenda, ashtu edhe jashta shtetit

Po e fillojmë artikullin tonë, duke treguar se si jemi ndier kur e kuptuam nga lajmet e ditës së djeshme, se sot me datën 31.01.2018, do të ketë protestë në



kryeqytetin e Kosovës. Arsyeja se pse po mbahet kjo protestë është kundër ajrit shumë të ndotur. Ne menjëherë supozuam se, për shkak të këtij problemi, deputetët do të mblidheshin sot dhe do të diskutonin për këtë shqetësim që i ka kapluar qytetarët e Prishtinës. Jo se ne nuk u brengosëm për këtë çështje, por ne e kishim edhe një brengë tjetër. Ne e kishim të rezervuar për sot të vinim në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“, si dhe të shkonim e të vizitonim Kuvendin. Sapo erdhëm këtu, trajneret na treguan se kjo vizitë është

e pamundur të realizohet. Por gjithsesi, edhe pse nuk e bëmë këtë vizitë, ne u kënaqëm shumë në rolin e gazetarit. Çfarë na kënaqi edhe më shumë, ishte tema të cilën e shtjelluam në grupin e vogël e cila lidhet me rolin e gazetarit. Është fjala për median.

Media është mjet informimi, e cila ashtu siç na informoi përmes lajmeve televizive për protestën e sotme në Prishtinë, ajo na informon edhe për shumë gjëra tjera.

Median e përbëjnë gazetatat, revistat, librat, etj. të cilat hyjnë në grupin e medias së shkruar. Pastaj, është televizioni, kompjuteri, radio, rrjetet sociale, etj, të cilat hyjnë në grupin e medias elektronike.

Duam ta potencojmë edhe një herë rëndësinë e medias, sepse po të mos ekzistonte ajo, ne do të ishim të painformuar rreth ngjarjeve në Kosovë, por edhe shumë larg asaj se çka po ndodh në botë.



Gazetarë të mirëfilltë


## KATËR PUSHTETET NË KOSOVË

Prej se është shpallur shteti ynë shtet demokratik, çdo gjë funksionon shumë më mirë. E themi këtë, sepse edhe vetë pushteti i Kosovës ndahet në tri pushtete. Është Pushteti Legjislativ, i cili ushtrohet nga Kuvendi i Kosovës, Pushteti Ekzekutiv i cili ushtrohet nga Qeveria, si dhe Pushteti Gjyqësor i cili ushtrohet nga Gjykata. Këto janë tri degët e pushtetit, ku secila prej tyre e ka rëndësinë e vet. Mos të harrojmë se pushtet tjetër me shumë influencë është edhe media, e që njihet si pushteti i katërt. Media ka vlerë tejet të madhe tek ne qytetarët. Përmes saj, ne i kuptojmë të gjitha lëvizjet të cilat bëhen nga personat të cilët punojnë në institucionet e lartpërmendur, pra në Kuvendi, në Qeveri dhe në Gjykatë.


Edhe pse këto pushtete janë shumë të rëndësishme për ne Kosovarët, prapëseprapë fuqia na takon neve, sepse ne jetojmë në një shtet demokratik. Ne me votën tonë vendosim të ardhmen e vendit tonë.



Nëna demokraci, dora që na rriti në paqe



Në demokraci të gjithë jemi të barabartë



Zgjedhja e përfaqësuesve tanë me anë të votave



E drejta jonë në demokraci është shkollimi. E libri hyn në media të shkruara





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mustafa Baku“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prizren